

## MARRËVESHJE

### Për instalimin e Veprës Publike me titull "Bleta" të Artistit Sislej Xhafa

Sot, më datë 29.06.2021 (dy mijë e njëzetë e një) në Tiranë, lidhet kjo Marrëveshje ndërmjet Palëve:

- **Sislej Xhafa**, në cilësinë e artistit pamor, i ditëlindjes 08.10.1970, lindur në Pejë (Kosovë) dhe banues në New York (SHBA), i identifikuar me Pasaportë me nr. 488377260, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar (më tej referuar edhe si "Artisti");
- **Integrated Energy BV SPV**, shoqëri e regjistruar në formën ligjore të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT L72031013B, me adresë në Tiranë, Vaqarr, Sharrë, zona kadastrale 3321, indeks harte K-34-100 (25-C), (në vijim "Shoqëria"), përfaqësuar nga Administratori znj. **Arjola Kodra**, madhore dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Artisti dhe Shoqëria, këtu referuar bashkërisht si **Palët**, dhe veçmas si **Pala**, kanë vendosur dhe bien dakord për hartimin e kësaj Marrëveshje (më tej referuar edhe si "**Marrëveshja**"), për instalimin e veprës publike me titull "Bleta".

### **KUSHTET PARAPRAKE**

- A) Artisti pamor Sislej Xhafa, është autor i veprës publike me titull "Bleta", e cila do të instalohet në qytetin e Tiranës, pranë fshatit "Sharrë", brenda territorit të "Landfillit të Tiranës".
- B) Vepra artistike i përket mediumit *instalacion skulpturor*, me dimensione 51 cm gjerësi x 134 cm lartësi, e derdhur në bronz, (më tej referuar edhe si "Vepra"), pamja e së cilës vërtetohet sipas kopjes së Certifikatës së Autorësisë lëshuar prej artistit bashkëlidhur kësaj Marrëveshje.
- C) Vepra artistike është realizuar me mbështetjen e plotë të Platformës së Artit Bashkëkohor HARABEL (më tej referuar si "HARABEL"), e cila ka për qëllim inkurajimin, promovimin e artistëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë nëpërmjet mbështetjes dhe prezantimit të veprave të tyre artistike.
- D) Në bazë të Kontratës së Dhurimit të lidhur ndërmjet Artistit Sislej Xhafa në cilësinë e Dhuruesit, dhe HARABEL në cilësinë e Pranuesit të Dhurimit, e drejta e pronësisë mbi Veprën publike i përket HARABEL, pa cënuar të drejtat që lidhen me të drejtën e autorit.
- E) Në këto kushte, Sislej Xhafa në cilësinë e autorit të veprës publike, me anë të kësaj Marrëveshje, bie dakord t'ia japë shoqërisë Integrated Energy BV SPV, Veprën me titull "Bleta" që ta instalojë brenda territorit të Landfillit të Tiranës dhe ta mirëmbajë atë pa të drejtë shpërblimi, dhe pa një afat të përcaktuar, por në çdo rast për një afat minimal prej 5 (pesë) vite.
- F) Shoqëria Integrated Energy BV SPV, bie dakord që ta instalojë dhe mirëmbajë Veprën brenda territorit të Landfillit të Tiranës ku dhe ushtron kompetencën territoriale, sipas neneve të kësaj Marrëveshje.

*Kushtet paraprake janë pjesë përbërëse dhe e pandashme e Marrëveshjes.*

### **Neni 1**

#### **Objekti i Marrëveshjes**

- 1.1 Sislej Xhafa shpreh vullnetin që vepra publike me titull "Bleta", të instalohet dhe të mirëmbahet prej Shoqërisë Integrated Energy BV SPV, e cila bie dakord dhe pranon Veprën, me qëllim ekspozimin për një afat minimal prej 5 (pesë) vitesh, brenda territorit të Landfillit të Tiranës. Ky afat mund të zgjatet për sa kohë destinacioni i terrenit në të cilin po instalohet Vepra, nuk do të pësojë ndryshime. Në kuptimin e kësaj Marrëveshje, mirëmbajtja do të përfshijë pastrimin nga pluhurat, papastërtitë e

ambientit, gjelbërimin përrreth veprës publike duke treguar kujdesin e duhur për mbarëvajtjen e saj, si dhe çdo veprim tjetër të zakonshëm për këtë qëllim.

## Neni 2

### Hyrja në fuqi dhe Kohëzgjatja e Marrëveshjes

- 2.1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi nga momenti i nënshkrimit të saj dhe do të jetë pa afat të përcaktuar, për sa kohë që destinacioni i terrenit në Landfillin e Tiranës nuk do të pësojë ndryshime, por në çdo rast për një afat minimal prej 5 (pesë) vitesh.
- 2.3. Me mbarimin e afatit të kësaj Marrëveshje dhe/ose në rast mosmarrëveshje, vepra publike do t'i kthehet gjithmonë dhe në mënyrë të përhershme HARABEL, i cili ushtron të drejtën e pronësisë mbi sendin.

## Neni 3

### Të drejtat dhe detyrimet e Artistit

- 3.1. E drejta e autorit e veprës publike me titull "Bleta" i përket vetëm artistit pamor Sislej Xhafa, si një e drejtë ekskluzive, e patjetërsueshme dhe e paparashkrueshme. Vepra artistike "Bleta" është 1 (një) vepër origjinale dhe unike në llojin e saj. Autenticiteti i kësaj Pasurie të Luajtshme vërtetohet sipas kopjes së Certifikatës së Autorësisë të nënshkruar dhe lëshuar prej Artistit.
- 3.2. Artisti garanton se në rast se Palë të treta do të ngrenë pretendime në lidhje me autorësinë, originalitetin e Veprës, apo çfarëdo pretendimi tjetër që ka të bëjë me të drejtat vejjake jo pasurore, përgjegjësi ligjore do të mbajë vetëm autori, duke përjashtuar Palë të tjera lidhur me këto pretendime. Në këtë rast, HARABEL dhe Shoqëria Integrated Energy BV SPV, do të jenë të shkarkuara nga çdo përgjegjësi ligjore, nga çdo barrë, dëm apo shpenzim, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që mund të lindë si rezultat i kërkesave, pretendimeve ose nismave të Palëve të treta. Në raste pretendimesh nga Palë të treta, Artisti është i detyruar t'i zgjidhë ato personalisht pa penguar HARABEL dhe shoqërinë Integrated Energy BV SPV, të përdorin lirisht Veprën.
- 3.3. Artisti deklaron se nuk do ta tjetërsojë Veprën, nuk do e japë me qira, nuk do e riprodhojë plotësisht apo pjesërisht atë, si dhe ndalohet riprodhimi i saj prej personave të tretë.
- 3.4. Gjithashtu, ndalohet secila prej Palëve në këtë Marrëveshje, si dhe çdo Palë tjetër të riprodhojë, të ekspozojë, të shpërndajë, të importojë, të eksportojë kopje të veprës publike dhe/apo të ngjashme me të për qëllime të ndryshme, dhe riprodhimi e shpërndarja e saj ndalohet me ligj.
- 3.5. Artisti, duke marrë në konsideratë faktin se vepra publike do të ekspozohet në një hapësirë të hapur për një periudhë të gjatë kohore, shkarkon plotësisht Shoqërinë Integrated Energy BV SPV nga çdo përgjegjësi ligjore në lidhje me dëmtimet potenciale për shkak të forcës madhore, kushteve klimaterike, amortizimit, rënies së zjarrit, si edhe çdo dëmtimi që mund të pësojë Vepra si rrjedhojë e përdorimit të saj.
- 3.6. Në lidhje me dëmtimet potenciale për shkak të forcës madhore, rënies së zjarrit, si dhe çdo dëmtimi që mund të pësojë Vepra, HARABEL merr përsipër të riprodhojë Veprën "Bleta" dhe ta ekspozojë në hapësirën e përcaktuar në këtë Marrëveshje ose në një hapësirë tjetër që e sheh të arsyeshme. Të drejtën ekskluzive për riprodhimin e Veprës e ka vetëm HARABEL, duke përjashtuar kështu edhe Artistin, Shoqërinë apo persona të tjerë.

## Neni 4

### Të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë

- 4.1. Shoqëria Integrated Energy BV SPV merr përsipër të lejojë instalimin, të mirëmbajë dhe ekspozojë Veprën në shërbim të publikut pa një afat të përcaktuar, për sa kohë që destinacioni i terrenit në Landfillin e Tiranës nuk do të pësojë ndryshime, por në çdo rast për një afat minimal prej 5 (pesë) vitesh;

Shoqëria nuk do të ndryshojë në asnjë rast qëllimin për të cilin është krijuar Vepra; vendin e qëndrimit, pozicionimin dhe/ose spostimin e saj në vende të tjera publike apo private; si dhe nuk do të bëjë asnjë ndryshim të dukshëm material ose fizik të Veprës, që do të ndikonte mbi të drejtën e autorit të veprës publike. Çdo ndryshim i mundshëm do të bëhet vetëm me pëlqimin dhe miratimin paraprak e në mënyrë të shprehur të Artistit i cili gëzon të drejtën e autorit nga njëra anë, dhe HARABEL i cili gëzon të drejtën e pronësisë mbi sendin nga ana tjetër.

- 4.2. Shoqëria Integrated Energy BV SPV nuk ka të drejtë të përdorë veprën publike në kapërcim të termave të përcaktuara në këtë Marrëveshje, nuk ka të drejtë ta japë veprën publike me qira, nënqira, ta tjetërsojë dhe t'ja kalojë në përdorim personave të tretë dhe/ose çdo autoriteti tjetër. Gjithashtu, nuk ka të drejtë të përfitojë nga të drejtat ekonomike të Veprës duke vendosur çmim bilete dhe/ose çdo tarifë tjetër për vizitimin e saj prej publikut vendas dhe të huaj.
- 4.3. Shoqëria Integrated Energy BV SPV merr përsipër të mirëmbajë Veprën publike objekt të kësaj Marrëveshje, dhe në mënyrë eksplicite të kryejë: pastrimin nga pluhurat, papastërtitë e ambientit, mirëmbajtjen e vazhdueshme të gjelbërimit përreth saj duke treguar kujdesin e duhur për mbarëvajtjen, si dhe çdo veprim tjetër të zakonshëm që lidhet vetëm me qëllimin e sipërpërmendur.
- 4.4. Mirëmbajtja nuk do të përfshijë rastet kur dëmtimi i veprës publike do të vijë si pasojë e dukurisë së forcës madhore, vjedhjes apo rënies së zjarrit për çdo lloj shkak. Mirëmbajtja nuk do të përfshijë dëmtimet që mund të pësojë vepra publike për shkak të amortizimit në kursin e zakonshëm të saj.
- 4.5. Sigurimi i veprës publike nuk do të jetë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshje. Shoqëria Integrated Energy BV SPV shkarkohet nga çdo përgjegjësi financiare dhe/ose shpërblyese si pasojë e dëmtimit të veprës për shkaqet e përmendura në pikën 4.4 të këtij neni.
- 4.6. Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 2 të kësaj Marrëveshje, ose në rastet kur Marrëveshja zgjidhet përpara afatit, Shoqëria ka detyrimin t'ia kthejë Veprën HARABEL në gjendjen në të cilën ndodhet, me ndryshimet dhe përqendrimet që Vepra mund të ketë pësuar si pasojë e ekspozimit të saj në vend të hapur, përdorimit të saj afatgjatë, si dhe kushteve klimaterike.
- 4.7. Shoqëria Integrated Energy BV SPV, merr përsipër që të gjitha shpenzimet për çmontimin, paketimin dhe transportin për kthimin e veprës publike të HARABEL në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 2 të kësaj Marrëveshje, ose në rastet kur Marrëveshja zgjidhet përpara afatit, do të përballohen prej saj.

#### Neni 5

##### Zgjidhja e Marrëveshjes

- 5.1. Palët kanë të drejtë ta zgjidhin këtë Marrëveshje përpara afatit të përcaktuar në nenin 2 më sipër, me anë të një *njoftimi me shkrim* drejtuar Palëve të tjera, 2 (dy) muaj përpara në adresat e përcaktuara sipas nenit 6 më poshtë, vetëm në rast se rezulton se vepra publike po përdoret për qëllime të ndryshme nga qëllimi që përcaktohet në objektin e kësaj Marrëveshje.
- 5.2. Në rast se Marrëveshja zgjidhet, Shoqëria detyrohet t'ia kthejë veprën HARABEL (pronari i veprës publike), dhe njëkohësisht të marrë të gjitha masat për çmontimin e saj duke treguar kujdesin e duhur për mos dëmtimin e saj.

#### Neni 6

##### Njoftimet

- 6.1. Çdo njoftim, kërkesë ose komunikim tjetër formal ndërmjet Palëve duhet të jetë me shkrim dhe do të dërgohet në adresat elektronike si më poshtë:

➤ **Artisti**  
sislej@gmail.com



➤ **Integrated Energy BV SPV**  
info@iebv.al

➤ **HARABEL**  
info@harabel.com.al

6.2. Palët duhet të njoftojnë njëra-tjetrën për ndryshimet e mundshme të adresave, brenda 5 (pesë) ditësh pune nga ndryshimi i tyre, në të kundërt, çdo njoftim i dërguar në adresën e fundit të komunikuar prej tyre do të konsiderohet i kryer. Secila prej Palëve ruan të drejtën e shpërblimit të çdo dëmi të ardhur si rezultat i mos njoftimit të ndryshimeve të adresave të Palëve.

## Neni 7

### Ligji i zbatueshëm


- 7.1. Kjo Marrëveshje është hartuar në bazë të legjislacionit shqiptar, konkretisht Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 36/2015 "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me to", dhe interpretimi, rregullimi e zbatimi i saj i nënshtrohet dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 7.2. Çdo parashikim i Marrëveshjes që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së saj dhe në këndvështrimin e qëllimit të mirë që i shtyu Palët të lidhin këtë Marrëveshje, që është instalimi dhe ekspozimi i Vepërës në Landfillin e Tiranës për vizitimin prej publikut vendas dhe të huaj, si një Vepër, krijimi i së cilës lidhet ngushtë me territorin në të cilin është instaluar.
- 7.3. Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes Palëve gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshje do të zgjidhen me mirëkuptim dhe në rast se kjo është e pamundur, Palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Tiranës.
- 7.4. Kjo Marrëveshje u hartua në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe dhe secila prej Palëve të përmendura në këtë Marrëveshje do të mbajë nga një kopje.

Bashkëlidhur kësaj Marrëveshje gjenden:

1. Fotokopje të pasaportës dhe letërnjoftimit të Palëve;
2. Ekstrakt i shoqërisë Integrated Energy BV SPV;
3. Kopje e Certifikatës së Autorësisë lëshuar prej artistit.

**ARTISTI PAMOR**

Z. Sislej Xhafa



Sislej Xhafa

**Shoqëria "Integrated Energy BV SPV"**

Znj. Arjola Kodra



Integrated Energy BV SPV  
Tiranë - Albania





Mbledhja e identitetit ID



REPUBLIKA E SHQIPËRIE REPUBLIC OF ALBANIA

Identifikuesi

Kodra

Identifikuesi i shtetëror

A/101a

Shqipëri/Albanian

Identifikuesi i shtetëror

Tiranë, ALB

Identifikuesi i shtetëror

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

Identifikuesi i shtetëror

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

Emri i shtetëror

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

Emri i shtetëror

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]

[Redacted]